



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 731 Akti

Nr. 591 Vendimi  
Tiranë, më 23.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 22.11.2022, ora 14:00, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**     **Z. Eugen Papandile**, me detyrë ish-këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese.

**BAZA LIGJORE:**                    **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;  
**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile ka ushtruar detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2.5.2013 – 31.12.2017 dhe në vazhdim ushtron detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm pranë kësaj Gjykate. Z. Eugen Papandile, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 165<sup>1</sup> të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bën pjesë në subjekte të rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*.

**2.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile

<sup>1</sup> Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë 1. Këshilltari i gjyqarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

do t'i nënshtrohej procesit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Valbona Sanxhaktari dhe Alma Faskaj relatores.

**3.** Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK).

**4.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), i ngritur me short, me vendimin e datës 21.6.2021 vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

**5.** Në datën 7.7.2021 subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe përbërjen e trupit gjykues, për të cilin nuk deklaroi nëse kishte ose jo konflikt interesi me ndonjë nga anëtarët e tij.

**6.** Po në datën 7.7.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, duke iu dërguar edhe pyetësori standard.

**7.** Në përgjigje të *email*-it të dërguar, në datën 28.7.2021 subjekti nuk i është përgjigjur pyetësorit standard, duke përcjellë një kërkesë, në të cilën parashtron pretendimet e tij për t'u mos iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit, duke theksuar se procesi i rivlerësimit ndaj tij duhet të ndërpritet, pasi në kushtet aktuale nuk është më subjekt i rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës.

**8.** Z. Eugen Papandile, në datën 15.11.2022, me anë të postës elektronike, është njoftuar nga Komisioni lidhur me procesin e tij të rivlerësimit dhe në kuadër të një procesi të rregullt e në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar Komisioni e ka ftuar që të shprehë vullnetin e tij në seancën dëgjimore, fokusi i së cilës do të ishte përfundimi i procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës.

**9.** Z. Eugen Papandile në datë 17.11.2022 ka paraqitur një kërkesë për shtyrje të afatit të depozitimit të parashtrimeve, me argumentin se nuk e kishte parë *email*-in. Komisioni e mori në konsideratë këtë kërkesë, duke i lënë një afat tjetër dhe pa dyshim mundësinë që në seancën dëgjimore subjekti mund të parashtronte argumente shtesë.

**10.** Komisioni, me vendimin nr. 3, datë 18.11.2022, vendosi kalimin e çështjes në seancën dëgjimore.

**11.** Në seancën dëgjimore të datës 22.11.2022 subjekti pretendoi se nuk ishte njoftuar me *e-mail* për datën e seancës, por ka marrë dijeni në rrethana të tjera. Komisioni analizoi këtë pretendim të subjektit dhe konstatoi se për arsye subjektive *email*-i nuk i ishte dërguar subjektit, por njoftimi i datës së seancës dëgjimore ishte bërë publike në të gjitha mënyrat e parashikuara në rregulloren e Komisionit. Sa më sipër, subjekti ushtroi të drejtën e dëgjimit në seancën dëgjimore publike, duke iu garantuar respektimi i procesit të rregullt ligjor.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**12.** Z. Eugen Papandile, në kërkesën e tij drejtuar Komisionit, parashtrroi si vijon:

#### **12.1** *Ai nuk është më në pozicionin e këshilltarit ligjor në Gjykatën Kushtetuese*

Subjekti, ndër të tjera, shpjegon se: "Kam punuar si këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2.5.2013 deri në datën 31.12.2017. Ndërkohë, nga data 1.1.2018 e në vijim jam emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese. Nuk rezultoi se unë kam dhënë dorëheqje nga detyra si këshilltar, pasi jam zgjedhur nga mbledhja e gjyqtarëve në postë institucion, por tashmë me një status të ri, atë të nëpunësit më të lartë civil".

**12.2** *Ai pretendon se i është nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga KED-ja gjatë procesit të kandidimit të tij për anëtar të Gjykatës Kushtetuese*

Subjekti parashtron se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ashtu si edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, janë të dy institucione të pavarura, si dhe organe kushtetuese. Pra, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka çmuar *de facto* dhe *de jure* se ka juridiksion dhe kompetencë për ta bërë ezaurues hetimin administrativ mbi pasurinë, profesionalizmin etj., të kandidatit/subjektit Eugen Papandile, duke shfrytëzuar edhe organet ndihmëse si ILDKPKI, etj.

Po në raste të ngjashme (edhe ish-këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese) KED-ja ka pritur përfundimin e hetimit të KPK-së në lidhje me kalimin me sukses të kriterit të pasurisë për kandidatët, të cilët kanë qenë subjekte të rivlerësimit kalimtar.

Si përfundim, subjekti ka shprehur bindjen se rivlerësimi kalimtar si ish-këshilltar i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të bëhet, pasi tashmë kjo është një gjë e gjykuar, si dhe Komisioni nuk ka tashmë kompetencë apo juridiksion për ta bërë këtë gjë. E kundërta, sipas pretendimeve të subjektit, do të ishte cenim i shumë parimeve kushtetuese, për më tepër cenim i sigurisë juridike. Subjekti citon: *“Nuk mundet që unë të bëj sa herë të më kërkohet rivlerësim pa fund (të paktën deri në datën kur ka marrë formë të prerë) si nga Gjykata e Apelit Administrativ (nr. \*\*\*, datë 2.12.2020) apo vendimi përfundimtar i KED-së (nr. \*\*\*, datë 23.11.2020)”*.

KED-ja, si organi administrativ i pavarur, e ka ezauruar juridiksionin dhe kompetencën në rastin e subjektit, duke bërë rivlerësimin e tij kalimtar sipas legjislacionit në fuqi.

**12.3** *Lidhur me faktin e moskryerjes së testimi nga Shkolla e Magjistraturës, pjesë e rivlerësimit profesional, subjekti parashtron se duke pasur statusin e nëpunësit civil, grada më lartë e statusit, nuk mund të merrte pjesë në testimin e Shkollës së Magjistraturës, për këtë arsye objekti për të cilin Komisioni duhet të nisë punën bëhet i pamundur.*

**13.** Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese<sup>2</sup> mbi procedurën e rekrutimit të subjektit në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese<sup>3</sup> informoi se z. Eugen Papandile nga data 2.5.2013 deri më 31.12.2017 ka mbajtur pozicionin e këshilltarit të gjyqtarit në këtë gjykatë, ndërsa që prej datës 1.1.2018 ushtron funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 19.12.2017, të mbledhjes së gjyqtarëve. Gjykata Kushtetuese informon gjithashtu se në dokumentacionin që disponohet në lidhje me këtë procedurë, subjekti nuk ka administruar dorëheqje me shkrim apo shkarkim/lirim nga funksioni si këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

**14.** Nga dokumentacioni i analizuar rezultoi se subjekti ka depozituar “kërkesën për punësim në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm”, regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, drejtuar Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, në të cilën shpreh interesin për pozicionin vakant të Sekretarit të Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese. Z. Eugen Papandile e ka depozituar kërkesën për punësim ndërsa ishte ende në detyrën e këshilltarit të Gjykatës Kushtetuese.

**15.** Komisioni, për një hetim të pavarur dhe gjithëpërfshirës, iu drejtua gjithashtu Shkollës së Magjistraturës<sup>4</sup> lidhur me periudhën e testeve të zhvilluara dhe nëse z. Eugen Papandile ka marrë pjesë dhe si është vlerësuar në testimet e zhvilluara. Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, Shkolla e Magjistraturës informon Komisionin se z. Eugen Papandile nuk ka marrë pjesë në provimin për testimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio* të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës në datat 7 dhe 8 maj 2018. Shkolla e Magjistraturës informon gjithashtu se z. Eugen Papandile nuk ka aplikuar dhe nuk ka marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara prej saj.

**16.** Nga burimet e hapura, të aksesueshme lehtësisht prej Komisionit dhe të panevojshme të provohen me prova pasi kanë statusin e fakteve të njohura botërisht, sipas përcaktimit të nenit

<sup>2</sup> Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 13.9.2021.

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.9.2021, e Gjykatës Kushtetuese.

<sup>4</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2021, e Shkollës së Magjistraturës.

13 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për z. Eugen Papandile ka nxjerrë dy vendime:

- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.10.2020, ka vendosur “Ndalimin e kandidimit të kandidatit Eugen Papandile në vendin vakant për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019”.
- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.11.2020, ka vendosur “Ndalimin e kandidimit të kandidatit Eugen Papandile në vendin vakant për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019”.

Vendimet e mësipërme janë ankimuar nga z. Eugen Papandile në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka vendosur “Pranimin e pjesshëm të padisë, shfuqizimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 9.10.2020, në aspektin e verifikimit shterues të kriterit përvojë profesionale”.

## II. ANALIZA LIGJORE MBI ARSYET E NDËRPRERJES SË PROCESIT

**17.** Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi referuar rrethanave të çështjes dhe dokumentacionit të administruara u konstatua se:

- a) Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e këshilltarit ligjor në njësinë ligjore në Gjykatën Kushtetuese në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të pikës 4 të nenit 179/b bën pjesë në rrethin e subjekteve *ex officio*.
- b) Subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile ka paraqitur një kërkesë me shkrim të motivuar për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa ishte ende duke ushtruar detyrën si këshilltar ligjor po pranë kësaj Gjykate.
- c) Marrëdhënia e punës si këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese ka përfunduar me emërimin e tij, sipas vendimit nr. \*\*\*<sup>5</sup>, datë 19.12.2017, të mbledhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, pasi pika 2 e vendimit ka përcaktuar se emërimi në detyrë i fillon efektet nga data 1.1.2018.

**18.** Komisioni, në respektim të detyrimit për të arsyetuar mbi çdo pretendim të ngritur, arsyeton:

### **18.1** A e gëzon subjekti i rivlerësimit statusin e magjistratit?

Rezulton e provuar se z. Eugen Papandile ka ushtruar detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2.5.2013 – 31.12.2017. Nga data 1.1.2018 dhe në vazhdim ushtron detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm pranë Gjykatës Kushtetuese. Z. Eugen Papandile, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës bën pjesë në subjektet e rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*. Neni 165<sup>6</sup> i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar se: “*Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese... që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, është subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’*”.

<sup>5</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 13.9.2021, e Gjykatës Kushtetuese.

<sup>6</sup> Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë. 1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekte të procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga analiza e ligjit në fjalë (nr. 96/2016) rezulton që këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese nuk është magjistrat<sup>7</sup>, rrjedhimisht nuk gëzon statusin e magjistratit, por i nënshtrohet procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016.<sup>8</sup>

**18.2** *A do të konsiderohet i ezauruar në kompetencë dhe juridiksion kontrolli i ushtruar në tri kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe analizimi i aftësive profesionale nga organet e pavarura kushtetuese KED, ILD, KLGJ i kryer për z. Papandile në momentin e kandidimit të tij në vakancat e krijuara për anëtar të Gjykatës Kushtetuese?*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një nga institucionet kushtetuese të pavarura të krijuar me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisht së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës.

Procesi i rivlerësimit kryhet nga Komisioni mbi bazën e tri kriterëve: (a) vlerësimi i pasurisë; (b) kontrolli i figurës; dhe (c) vlerësimi i aftësive profesionale – është një hetim administrativ i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Në analizë të sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 84/2016, i cili ka parashikuar në kreun III, neni 5 “Institucionet e rivlerësimit”, *procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.*

Sa më sipër, pavarësisht faktit se z. Eugen Papandile i është nënshtruar kontrollit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale nga organe të tjera të pavarura kushtetuese, siç është edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ato janë kryer në kuadër të veprimeve verifikuese lidhur me plotësimin e kriterëve ligjore pas kandidimit të z. Papandile në vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese. Komisioni kryen hetim administrativ të pavarur dhe gjithëpërfshirës në përgjigje të detyrimeve ligjore kushtetuese të procesit të rivlerësimit, pavarësisht faktit se aktorët pjesëmarrës dhe institucionet ndihmëse në kryerjen e këtij procesi janë të njëjtë.

Në analizë të sa më sipër, Komisioni çmon se nuk është ezauruar juridiksioni dhe kompetenca nga KED-ja për rivlerësimin e z. Eugen Papandile në kuptim të kriterëve të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me arsyen tjetër të parashtruar në kërkesën e subjektit për të mos filluar procesi i rivlerësimit ose për ta pushuar atë, Komisioni vlerëson se nuk është e mbështetur në ligj, pasi subjekti deri në datën 1.1.2018 ka qenë në detyrën e këshilltarit ligjor në Gjykatën Kushtetuese. Komisioni nuk mund të vendosë pushimin e procedurës së rivlerësimit, pasi bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016, “dorëheqja jo e shkruar” dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës që e bënte subjekt *ex officio* është dhënë pas afatit 3-mujor të parashikuar nga ky nen.

## **19. Ndërprerja ose jo e procesit të rivlerësimit dhe sanksionet**

**19.1** Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk është më në detyrën e këshilltarit ligjor të Gjykatës Kushtetuese, detyrë e cila i ka dhënë statusin e subjektit *ex officio* të rivlerësimit sipas nenit 179/b, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe pretendimit të tij në kërkesë se: “...nuk rezulton se unë kam dhënë dorëheqjen nga detyra si këshilltar pasi jam zgjedhur nga mbledhja e gjyqtarëve në po atë institucion, por tashmë kam një status të ri, atë të nëpunësit më të lartë civil...” me qëllim analizimin e plotë dhe saktësisht të rrethanave ligjore të bazuara në prova, duke marrë në konsideratë parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës lidhur pazgjidhshmërisht edhe me pasojat që sjell ndërprerja e procesit të rivlerësimit në rastin e dorëheqjes nga detyra,

<sup>7</sup> Germa “gj” e nenit 2 të ligjit nr. 96/2016.

<sup>8</sup> Pika 1 e nenit 165 të ligjit nr. 97/2016.

Komisioni çmon se jemi përpara përmbushjes së kritereve të nenit G në rastin e subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile.

**19.2** Bazuar në praktikën e rekrutimit të përcjellë nga Gjykata Kushtetuese për z. Eugen Papandile rezultoi se me shprehjen e interesit “kërkesë për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm pranë Gjykatës Kushtetuese”, si dhe vijimin e ushtrimit të këtij funksioni prej datës 1.1.2018, ai ka shprehur vullnetin e pavesuar për të mos ushtruar në vijim me detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese.

“Akti administrativ i dorëheqjes” së subjektit të rivlerësimit, i bërë efektiv në datën 1.1.2018, sipas të cilit që nga kjo datë z. Eugen Papandile nuk do të mund të ushtronte detyrën si këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese, sjell si pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi (*ex officio*) në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh<sup>9</sup> që, referuar nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, realizohet përfundimisht nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit (pa marrë në konsideratë pezullimin shoqëruar me edukim të detyrueshëm, duke qenë se kjo është masë e përkohshme, e cila në vijim do të përfundojë me vendimmarrje të organit rivlerësues për konfirmim në detyrë apo shkarkim).

**19.3** Në këto kushte, Komisioni çmon se shprehja e interesit për pozicionin vakant Sekretar i Përgjithshëm i subjektit të rivlerësimit, e cila ka ndodhur pas afatit të parashikuar nga neni 56 i ligjit nr. 84/2016 dhe përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit, konsiston në parimin dorëheqje nga detyra, sipas procedurës së nenit G të Aneksit të Kushtetutës, pasi edhe pse nuk kemi në formë, përmbajte dhe procedurë si dorëheqje me shkrim, por akt lirimi apo shkarkimi nga detyra si këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese. Z. Eugen Papandile ka ushtruar vullnetarisht të drejtën e tij kushtetuese lidhur me vijimin e karrierës profesionale. Dorëheqja sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016, e cila rrjedh nga një dispozitë me karakter parimor dhe themeltar si neni G i Aneksit të Kushtetutës, “dorëheqja”, është e mjaftueshme për prodhimin e pasojave juridike të ndërprerjes së procesit të rivlerësimit dhe të ndalimit të emërimit për 15 vjet si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm.

**19.4** Për rrjedhojë, lidhur me institutin e dorëheqjes nga detyra në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit<sup>10</sup> dhe orientimin e dhënë në trajtimin prej tij të çështjeve në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, në pikën 4, fjalialia e dytë përcakton *si subjekte të cilat mund t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit, ish-gjyqtarët, ish-prokurorët dhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, nuk gjen zbatim në rastin e z. Eugen Papandile.*

Kolegji i Posaçëm i Apelit ka orientuar Komisionin<sup>11</sup> që “për zgjidhjen e çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë...”.

<sup>9</sup> Shihni vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2019, të Kolegjit, e cila sjell edhe: “...pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ dhe nenit 58, pika 1, nënparagrafët ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’ të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, realizohet përfundimisht nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, e cila në vijim do të përfundojë me vendimmarrje të organit rivlerësues për konfirmim në detyrë apo shkarkim”.

<sup>10</sup> Shihni vendimet nr. \*\*\*, datë 11.6.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 10.9.2018, faqja 12 nga 14, e Kolegjit.

<sup>11</sup> Pika 97, vendimi nr. \*\*\*\*, subjekt rivlerësimi A.LL.

Në pikën 94 të këtij vendimi, Kolegji vlerëson shprehjen e vullnetit të pavesuar si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, ndërsa në pikën 56 të tij, Kolegji ka përcaktuar se: “...verifikimi i vullnetit të subjektit të rivlerësimit për t’u dorëhequr nga procesi i rivlerësimit kalimtar është kompetencë, por edhe detyrim kushtetues i Komisionit...”.

Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilave Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

**19.5** Në lidhje me mungesën e një vullneti të qartë dorëheqjeje të subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile si këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe mungesa e një akti shkarkimi apo lirimi nga kjo detyrë, Komisioni çmon se këto mungesa nuk janë kusht për ndalimin e ardhjes së pasojave të parashikuara në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar nga njëra anë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, e duke lënë hapësirën për të përfutur nga moszbatimi i sanksioneve të parashikuara në pikën G të Aneksit të Kushtetutës është ambig, me qëllim shmangien e procesit të rivlerësimit.

Në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr. 99/2016), “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, neni 13 “Mbledhja e gjyqtarëve”, germa “dh”, parashikon se mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm.

Sekretari i Përgjithshëm<sup>12</sup> është nëpunësi më i lartë civil dhe emërohet nga mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me propozim të Kryetarit, nga radhët e juristëve me përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet.

**19.6** Z. Eugen Papandile me veprime konkludente, edhe pse jo sipas formës, procedurës dhe afatit të kërkuar nga ligji, ka dhënë dorëheqjen nga funksioni si këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetutës.

Ky qëndrim është mbajtur edhe në vendimin nr.\*\*\*, datë 17.6.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku citohet: “15.8 ...ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, e cila, në kuptim të procesit të rivlerësimit, do të konsiderohet dhe kualifikohet ligjërisht si dorëheqje nga detyra, për shkak se është mbështetur në vullnetin e shprehur të vetë subjektit të rivlerësimit. Motivet që e kanë shtyrë subjektin drejt këtij manifestimi vullneti, konsiderohen pa ndikim në kualifikimin e tij si dorëheqje dhe të pasojave ligjore që ai krijon, për sa kohë që vetë kuadri ligjor nuk i ka paraparë ato si përcaktuese për ndonjë konsekuencë të tillë”.

**20. Lidhur me pretendimin se procesi duhet të ndërpritet pa një vendim përfundimtar**

**20.1** Në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: “Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”.

Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 103 të tij, përcakton se: “1. Procedimi administrativ përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar zbulon se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. 2. Deklarimi i përfundimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë gjithnjë i arsyetuar dhe kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë”.

**20.2** Referimi nga ana e subjektit të rastit të subjektit të rivlerësimit M. Xh., trajtuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 11.3.2019, të Komisionit, ashtu si Kolegji i Posaçëm i Apelit, çmon se referimi në vendimin nr. \*\*\*, datë 17.6.2022, është jorelevant, për sa kohë që mes rastit të përmendur

<sup>12</sup> Neni 14, Administrata e Gjykatës Kushtetuese, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr. 99/2016), “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

dhe çështjes objekt shqyrtimi qëndron në themel një ndryshim i rëndësishëm lidhur me situatën faktike. Subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij e ka humbur statusin për shkak të dorëheqjes nga detyra që mbante dhe, për pasojë, procedura që do të zhvillohej ndaj tij *ex officio*, duhej të ndërpritej, duke u shoqëruar me aplikimin e pasojave të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

**20.3** Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga detyra e këshilltarit ligjor. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes nga detyra të subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Eugen Papandile.
2. Ndalimin e emërimit të z. Eugen Papandile si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 23.11.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
Kryesuese

**Valbona SANXHAKTARI**  
Anëtare

**Alma FASKAJ**  
Relatore

*Sekretare gjyqësore*  
*Albana Plaka*